

FINANCA

Buletini Majo | KORRIK 2026



MINISTRI MALAJ: TË ARDHURAT U RRI TËN FALË MIRADMINISTRIMIT DHE JO RRI TJS SË BARRËS FISKALË, EKONOMIA VIJON RRI TJEN E QËNDRUESHME

Ministri Petrit Malaj zhvilloi një konferencë për mediat ku prezantoi treguesit ekonomikë dhe fiskalë të gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, duke theksuar se ekonomia shqiptare vijon të ndjekë një trajektore të qëndrueshme rritjeje dhe konsolidimi. Ministri tha se

rezultatet e gjashtëmujorit konfirmojnë rritjen e të ardhurave buxhetore, përmirësimin e mëtejshëm të formalizimit të ekonomisë, si dhe vazhdimin e trendit pozitiv në punësim dhe aktivitetin ekonomik. Të ardhurat totale buxhetore u realizuan në masën e 105% të planit të periudhës, ndërsa të ardhurat e mbledhura nga administrata tatimore, doganore dhe kontributet arritën në 359.3 miliardë lekë, ose 7.1 miliardë lekë mbi plan. Ministri Malaj theksoi se kjo performancë është rezultat i miradministrimit tatimor dhe doganor, si dhe i zbatimit korrekt të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave, dhe jo i rritjes së taksave apo barrës fiskale.

▶ LEXO MË SHUMË

MIRATOHET MARRËVESHJA E HUASË ME SHBA PËR MODERNIZIMIN E KAPACITETEVE MBROJTËSE

Kuvendi i Shqipërisë ratifikoi Marrëveshjen e Huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përfaqësuar nga Agjencia e Bashkëpunimit për Sigurinë e Mbrojtjes (DSCA), në kuadër të programit të Financimit të Jashtëm Ushtarak (Foreign Military Financing – FMF). Marrëveshja parashikon një financim prej 302 milionë dollarësh amerikanë, i cili do të përdoret

për modernizimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura përmes programit Foreign Military Sales (FMS), duke financuar pajisje, sisteme dhe shërbime të mbrojtjes sipas standardeve të NATO-s. Financimi do të disbursohet gradualisht, në përputhje me nevojat konkrete të Ministrisë së Mbrojtjes dhe me miratimin e autoriteteve amerikane, ndërsa përdorimi i fondeve do të monitorohet nga DSCA, duke garantuar transparencë dhe administrim të përgjegjshëm të këtij financimi.

▶ LEXO MË SHUMË



PERFORMANCA PARAPRAKË E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR JANAR-QËRSHOR 2026

Të ardhurat totale, për periudhën Janar-Qershor 2026, arritën në rreth 410.6 miliardë lekë ose me realizim 105 % të planit të periudhës. Krahësuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ato u rritën me rreth 44.5 miliardë lekë ose 12.2 % më shumë, një realizim në masën 49.9 % të planit vjetor të mbledhjes së të ardhurave. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 6 mujore të vitit 2026, arritën në rreth 357.8 miliardë lekë me një realizim në masën 97.4% të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 ky zë ka rezultuar 7.5% më i lartë ose rreth 24.8 miliardë lekë më shumë.

▶ LEXO MË SHUMË



KUVENDI MIRATON NDRYSHIMET NË BUXHETIN E VITIT 2026, MË SHUMË MBËSHTETJE SOCIALE DHE FINANCIM PËR SEKTORËT PRIORITARË TË EKONOMISË

Kuvendi i Shqipërisë miratoi Aktin Normativ për ndryshimin e buxhetit 2026, i hartuar si rrjedhojë e

performancës pozitive të financave publike në 5 muajt e parë të vitit 2026, çka krijoi hapësira të nevojshme për financimin e disa politikave prioritare

▶ LEXO MË SHUMË



MALAJ ME SHEFIN E MISIONIT TË “DYFISHO SIPËRMARRJEN TËNDE”, MBËSHTETJE FINANCIARE PËR ZHVILLIMIN E NDMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË VEND

Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, mori pjesë në aktivitetin e prezantimit të Programit Kombëtar “Dyfisho

Sipërmarrjen Tënde”, ku shprehu angazhimin e qeverisë për të mbështetur zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, rritjen e produktivitetit të

▶ LEXO MË SHUMË



MINISTRI MALAJ, VIZITË NË LUSHNJE DHE FIER PËR ZBATIMIN E SKEMËS SË KOMPENSIMIT TË FERMERËVE ME TVSH 10%

Ministri Petrit Malaj zhvilloi një vizitë pune në Lushnje dhe Fier, për të ndjekur nga afër zbatimin e skemës së kompensimit të fermerëve në masën 10% të TVSH për shitjet e produkteve të tyre bujqësore. Ministri Malaj u bëri thirrje fermerëve që të aplikojnë për të përfituar nga skema e kompensimit me 10% të TVSH-së për shitjet e produkteve bujqësore dhe blegtorale, e cila synon të rrisë mbështetjen financiare për fermerët, të nxisë formalizimin e sektorit bujqësor dhe të krijojë kushte më të favorshme për zhvillimin e prodhimit vendas. Sipas vlerësimeve të Administratës Tatimore, nëse të gjithë fermerët që plotësojnë kriteret do të aplikojnë, vlera e kompensimit për periudhën janar-qershor 2026 pritet të arrijë rreth 13.8 milionë euro.

▶ LEXO MË SHUMË



MINISTRI PETRIT MALAJ PREZANTOI AKTIN NORMATIV TË BUXHETIT 2026 NË KOMISIONET PARLAMENTARE PËR EKONOMINË DHE ÇËSHTJET LIGJORE

Ministri Petrit Malaj prezantoi në komisionet parlamentare të Ekonomisë dhe Ligjeve Aktin Normativ për ndryshimin e buxhetit 2026, i hartuar si një domosdoshmëri për të reflektuar zhvillimet e evidentuara gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2026. Ndër politikat kryesore që financohen përmes Aktit Normativ, Ministri përmendi indeksimin e pensioneve me efekt financiar nga 1 korriku 2026, dyfishimin e pagesës për fëmijët me aftësi të kufizuara, mbulimin nga shteti të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për kujdestarët e personave me aftësi të kufizuara, si edhe financime shtesë për përmbushjen e angazhimeve në fushën e mbrojtjes dhe procesin e integritimit evropian.

▶ LEXO MË SHUMË

NDRYSHIME LIGJORE PËR MODERNIZIMIN E SISTEMIT FINANCIAR TË VENDIT DHE PËRAFRIMIN E LEGJSLACIONIT ME BE

Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, informoi pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave mbi miratimin e tre projektligjeve që lidhen me modernizimin e mëtejshëm të sistemit financiar të vendit tonë dhe përafrimin e kuadrit ligjor me atë të Bashkimit European. Përmes

projektligjeve janë propozuar ndryshime në ligjin “Për shërbimet e pagesave”, ligjin “Për sistemin e pagesave” dhe ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Ministri Malaj theksoi se ndryshimet e propozuara sjellin përfitime konkrete për qytetarët dhe biznesin, reduktim të kostove të shërbimeve financiare, rritje të sigurisë dhe efikasitetit në sistemin financiar, forcim të mbrojtjes së konsumatorëve, si dhe nxitje të konkurrencës dhe inovacionit në treg.

▶ LEXO MË SHUMË



MINISTRI MALAJ TAKOHET ME DREJTUESIN E RI TË BERZH-IT NË SHQIPËRI: FORCOJMË BASHKËPUNIMIN PËR PROJEKTE STRATEGJIKE

Ministri Petrit Malaj priti në një takim Drejtorin e ri të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Shqipëri, z. Hannes Takacs. Gjatë takimit u vlerësua partneriteti i qëndrueshëm ndërmjet Qeverisë

Shqiptare dhe BERZH-it, si një nga institucionet financiare ndërkombëtare që ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në financimin e projekteve strategjike për zhvillimin ekonomik të vendit. Ministri Malaj nënvizoi rolin e rëndësishëm të BERZH-it në financimin e projekteve me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe infrastrukturor të vendit, duke theksuar nevojën për thellimin e bashkëpunimit në sektorë prioritarë, në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe procesin e integritimit evropian të Shqipërisë.

▶ LEXO MË SHUMË

MIRATOHEN NDRYSHIMET NË LIGJIN “PËR KONTABILITETIN DHE PASQYRAT FINANCIARE”

Kuvendi i Shqipërisë miratoi ndryshimet në ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të cilat përafrojnë legjislacionin shqiptar me direktivat e BE në fushën e raportimit financiar. Këto ndryshime synojnë të rrisin cilësinë, krahasueshmërinë dhe transparencën e raportimit financiar, si dhe të përcaktojnë qartë

subjektet që do t’u nënshtrohen kërkesave të reja, duke ruajtur një qasje proporcionale për mikronjësitë dhe SME-të. Ndryshimet kryesore përfshijnë: forcimin e rregullave për konsolidimin e pasqyrave financiare; raportimin e qëndrueshmërisë; raportimin publik të tatimit mbi të ardhurat sipas juridiksioneve për grupet shumë të mëdha, me mbi 75 miliardë lekë të ardhura të konsoliduara për dy vite radhazi.

▶ LEXO MË SHUMË



FINANCIMI I PROJEKTIT TË NËNSTACIONIT TË RI TË OSHEE NË TIRANË, MARRËVESHJE GARANCIE MES SHQIPËRISË DHE BERZH

Ministri Petrit Malaj prezantoi në Kuvend projektligjin “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BERZH për financimin e projektit të Nënstacionit të OSHEE-së Tiranë”, një investim strategjik që synon

modernizimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë së furnizimit në kryeqytet. Marrëveshja mundëson financimin e ndërtimit të nënstationit të ri 110/20 kV në qendër të Tiranës nga OSHEE, ajo është ndërtuar mbi kushte të favorshme për qeverinë shqiptare dhe parashikon një hua në vlerën 22.5 milionë euro, me afat ripagese 10 vite, me normë interesi të ndryshueshme, të bazuar në Euribor 6-mujor plus një marzh prej 1%.

▶ LEXO MË SHUMË